




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE  
TË KOMISIONIT TË PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE  
PËR VITIN 2023**

**Prishtinë, qershor 2024**

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të KPMM kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Çështje tjetër

- 1 Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen se KPMM-ja kishte paqartësi lidhur me kalkulimin e rentës minerale e cila kalkulohet bazuar në UA. 01/2011 i nxjerrë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për rregullat dhe procedurat e mbledhjes së rentës minerale. Lidhur me këtë çështje kishte interpretime të ndryshme brenda KPMM-së, si tek komisionet profesionale ashtu edhe tek anëtarët e bordit.

Për këtë çështje, auditori nuk ka arritur të jap mendim për shkak se sqarimet duhet të ofrohen nga hartuesi i akteve nënligjore. Lidhur me kalkulimin e rentës minerale, ish Kryesuesja e Bordit në vitin 2022 kishte kërkuar interpretim profesional dhe ligjor tek Ministria e Ekonomisë (ME) si hartuese e këtij udhëzimi administrativ. Deri sa ne ishim në auditim, KPMM ende nuk kishte marrë përgjigje nga ME.

Veprimtaria e KPMM-së mbikëqyret nga Bordi ekzekutiv i përberë prej pesë (5) anëtarëve (njëri prej tyre kryesues), i cili emërohet nga Kuvendi i Kosovës. Gjatë vitit 2023, Bordi i KPMM-së nuk ishte funksional, përderisa më 26.10.2023 ishte shkarkuar nga Kuvendi i Kosovës. Kjo çështje nuk është në kompetencat e KPMM-së dhe si rezultat i kësaj ne nuk kemi rekomandim për këtë çështje.

Vlen të theksohet se më 22 maj të vitit 2024, Kuvendi i Kosovës kishte emëruar Bordi e ri në përbërje prej tre anëtarësh.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

UD i Drejtorit të KPMM-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, UD i Drejtorit të KPMM-së është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesuesi i Bordit të KPMM-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e prokurimit dhe obligimeve.

Ky raport ka rezultuar me tri (3) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja dhe një (1) rekomandim i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.1.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2023 ishte 369,281€, prej tyre ishin shpenzuar 334,446€. Ato kanë të bëjnë kryesisht për mirëmbajtje të automjeteve, naftë për ngrohje, mirëmbajtje të teknologjisë informative, shërbime të arsimit dhe trajnimit, etj

#### Çështja A1 - Mos përdorimi i modulit për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin të performancës së kontraktuesve

##### Gjetja

Neni 70.2 dhe 70.24.f. i Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, parasheh se vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet në sistem të prokurimit elektronik nga menaxherët e kontratës nëpërmjet të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve, gjatë dhe me përfundim të implementimit të kontratave publike dhe kontratave. Përgjegjësitë e menaxherit të kontratës janë që të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe arkivohen në modul për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik. Ndër kërkesat e rëndësishme të këtij moduli është që menaxheri i kontratës duhet që të regjistrojë kopjet e gjitha faturave për punimet, shërbimet apo furnizimet përfshirë letrat e punës që verifikojnë saktësinë e pagesave të kërkuara dhe detajet e pagesave të kryera, të autorizuara nga menaxheri i kontratës në sistemin e prokurimit elektronik

Gjatë testimit të procedurave të prokurimit kemi identifikuar se në pesë kontrata, nuk është përdorur moduli i e-prokurimit për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktorëve nga menaxherët e kontratave.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së njohurive të mjaftueshme të menaxherëve të kontratave dhe si rezultat i mos kryerjes së punëve me përgjegjësi nga ana e mbikëqyrësve të kontratave.

##### Ndikimi

Mungesa e vlerësimin të performancës së kontratës përmes sistemit të prokurimit elektronik, ndikon në menaxhim jo efektiv dhe transparent të kontratave si dhe nuk ofron mundësi që menaxhmenti në kohë reale të marr informata mbi performancën dhe realizimin e kontratës.

##### Rekomandimi A1

Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave të bëjnë administrimin dhe implementimin e kontratave nëpërmjet modulit për menaxhim të kontratave në sistem të prokurimit elektronik për të siguruar vlerësim adekuat të performancës së kontraktuesëve dhe informata mbi progresin e implementimit të kontratës.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.1.2 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2023, ishte 20,145€, në raport me vitin e kaluar kemi një zvogëlim të tyre në vlerë prej 7,094€ (2022 - 27,239€). Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2024.

### Çështja B1 - Vonesa në pagesa të obligimeve

**Gjetja** Neni 39 i LMFP, specifikon se, ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim, për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe /ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Në dy raste në vlerë prej 1,318€, kemi vërejtur që faturat e pranuar nuk ishin paguar me kohë. Vonesat ishin 9 përkatësisht 16 ditë, pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së buxhetit në fund të vitit dhe kontrolleve të pamjaftueshme në menaxhimin e borxheve.

**Ndikimi** Vonesa në pagesën e obligimeve mund ta bëjë KPMM-në subjekt të padive nga operatorët ekonomik duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbarimore apo obligime për vitin vijues.

**Rekomandimi B1** Kryesuesi i Bordit të KPMM-së duhet të forcojë masat e përgjegjësisë ndaj zyrtarëve financiar dhe zyrtarëve tjerë administrativ për të siguruar se të gjitha faturat do të paguhen brenda 30 ditësh pas pranimit të tyre.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.1.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

KPMM ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NJAB), e cila operon me një (1) auditor, bazuar në këtë ka planifikuar kryerjen e pesë (5) auditimeve për vitin 2023. Komiteti i auditimit gjatë vitit, kishte mbajtur katër (4) takime pune, në të cilat ka shqyrtuar raportet e auditimit dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të NJAB-së.

#### Çështja A2 - Mos realizimi i plotë i planit vjetor të NJAB-së dhe niveli i ulët i implementimit të rekomandimeve

##### Gjetja

Ligji Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, neni 23 ndër tjera përcakton që Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik, miraton planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm si dhe siguron zbatimin e rekomandimeve të pajtuara për auditim të brendshëm. Sipas planit vjetor të punës për vitin 2023, NJAB kishte planifikuar të kryej pesë (5) auditime në përputhje me afatet e përcaktuara.

NJAB gjatë vitit 2023 kishte realizuar tre (3) nga pesë (5) auditimet e planifikuara. Auditimet e kryera kanë të bëjnë me mbikqyrjen dhe inspektimin e bartësëve të licencave dhe lejeve, aktivitetet e jashtëligjshme minerare dhe auditimi i menaxhimit të sistemit të hyrave, përderisa auditimet që nuk ishin realizuar kanë të bëjnë me auditimin e Arkivës dhe auditimin e Departamentit të Gjeodezisë.

Po ashtu, sipas raportit vjetor të NJAB-së, niveli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin 2022 ishte i ulët. Nga 25 rekomandimet e dhëna, deri në fund të vitit 2023, pesë (5) rekomandime ishin zbatuar, 16 rekomandime ishin në proces të zbatimit dhe katër (4) rekomandime nuk ishin zbatuar nga njësitë e audituara. Situatë e njëjtë është edhe për rekomandimet e dhëna nga NJAB për vitin 2023.

Mos përmbushja e planit vjetor të NJAB-së, kishte ndodhur për shkak të vonesave në fillimin e zbatimit të këtij plani. Përderisa, zbatimi i ulët i rekomandimeve të dhëna nga NJAB ishte rezultat i neglizhencës së njësive të audituara dhe mungesës së kontrolleve të brendshme.

##### Ndikimi

Mos përmbushja e planit të auditimit mund të rezultojë që auditimi i brendshëm të mos mbuloj fushat me rrezik dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e vendimeve për parandalimin e gabimeve të mundshme në kohë, derisa niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve ndikon në mos përmirësimin e sistemeve të kontrollit dhe arritjen e objektivave të entitetit.

##### Rekomandimi A2

Kryesuesi i Bordit të KPMM-së duhet të siguroj realizimin e plotë të planit vjetor të auditimit, në mënyrë që të ofrohet mbështetja dhe siguria menaxhmentit në lidhje me efektivitetin e kontrolleve kyçe. Po ashtu të forcoj kontrollet që njësitë e audituara të implementojnë rekomandimet e dhëna nga NJAB.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>6</sup>	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>1,499,088</b>	<b>1,179,992</b>	<b>1,127,086</b>	<b>1,273,050</b>	<b>1,198,673</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	1,499,088	1,179,992	1,127,086	1,273,050	1,198,673

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 319,096€. Ky ndryshim ishte rezultat i zvogëlimit nga shkurtimet buxhetore me vendime të Qeverisë dhe Ministrisë së Financave, Punsës dhe Transfereve, kryesisht për shkak të mosrealizimit të projekteve kapitale.

Në vitin 2023 KPMM ka shpenzuar 96% të buxhetit përfundimtar ose 1,127,086€, me një rritje prej 2% në krahasim me vitin 2022.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>1,499,088</b>	<b>1,179,992</b>	<b>1,127,086</b>	<b>1,273,050</b>	<b>1,198,673</b>
Pagat dhe mëditjet	834,207	760,611	760,611	775,951	720,135
Mallrat dhe shërbimet	369,281	369,281	334,446	359,913	320,599
Komunalitë	30,600	30,600	15,028	16,514	15,926
Investimet Kapitale	265,000	19,500	17,000	120,672	142,014

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


- Tek pagat dhe mëditjet, buxheti përfundimtar është zvogëluar për 73,596€. Ky ndryshim është rezultat vendimit të MFPT nr.69-1/23, të datës 28.12.2023 për kursime buxhetore, për shkak të mungesës së anëtareve të bordit dhe mos plotësimit të pozitave të punës të cilat ishin të planifikuara me buxhet. Realizimi në këtë kategori ishte 760,611€ apo 100%.

- Tek mallrat dhe shërbimet, buxheti fillestar dhe ai final është i njëjti, ndërsa realizimi ishte 334,446€ apo 91%.

- Tek komunalitë, buxheti fillestar dhe ai final është i njëjti, ndërsa realizimi ishte 15,028€ apo 49%.

- Tek investimet kapitale buxheti përfundimtar është zvogëluara për 245,500€, si rezultat i vendimit të qeverisë nr.40/178 të datës 13.12.2023. Zvogëlimi i buxhetit dhe niveli ulët i shpenzimeve, janë rezultat i mos realizimit të tri projekteve kapitale të planifikuara si: projekti "Klima për Server Room" është realizuar nga mallrat dhe shërbimet pasi që oferta e pranuar për njësi ishte me pak se 1,000€, projekti "Automjete për inspektim në teren", nuk është realizuar për shkak të mos përfundimit të procedurave e prokurimit si rezultat i ankesave në OSHP; si dhe projekti "GPS për matje gjeodezike", nuk është realizuar për shkak se, fituesi i tenderit/kontratës nuk ka arritur të sjellë vërtetimin e ATK-ës dhe rezultat i kësaj nuk është nënshkruar kontrata. Realizimi në këtë kategori ishte 87% e buxhetit final.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në 2023 ishin në vlerë 27,628,569€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga licenca për gurëthyes dhe miniera, gjobat administrative, dhe taksa tjera administrative. Krahasuar më vitin paraprak kemi ulje të hyrave për 3,433,562€ apo 11%. Kjo ulje është si rezultat i mos lëshimit i licencave të reja në mungesë të bordit.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>31,258,945</b>	<b>31,258,945</b>	<b>27,628,569</b>	<b>31,062,131</b>	<b>20,029,887</b>
Të hyrat jo tatimore - renta minerare	30,200,000	30,200,000	26,722,409	29,857,478	19,235,177
Të hyrat jo tatimore taksa ngarkesa tjera	1,058,945	1,058,945	906,160	1,204,653	794,710

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2022 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale kishte rezultuar me gjashtë(6) rekomandime. KPMM kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, katër (4) rekomandime janë zbatuar, një (1) rekomandim është përsëritur, ndërsa një (1) rekomandim i mbyllur, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

### Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryesuesja e Bordit duhet të sigurojë aprovimin ose refuzimin e kërkesave për licencim brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj.	Në mungesë të licencave të lëshuara në vitin 2023 për shkak të mungesës së bordit, ne nuk kemi mundur ta vlerësojmë implementimin e këtij rekomandimi. Mirëpo kjo çështje do të jetë për vëmendje në vitin e ardhshëm pas plotësimit të bordit dhe dhënies së licencave.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryesuesja e Bordit duhet të sigurojë që pranimi i mallit të blerë, të bëhet vetëm nga komisioni i autorizuar, për të konfirmuar se furnizimet janë pranuar sipas cilësisë dhe sasisë së paraparë me kontratë.	Pas publikimit të raportit të auditimit për vitin 2022, të gjitha pranimet e mallrave dhe furnizimeve janë bërë me komision të pranimi.	I zbatuar
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryesuesja e Bordit duhet të sigurojë planifikimin e buxhetit në përputhje me natyrën e projekteve në mënyrë që pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.	KPMM gjatë vitit 2023 ka zbatuar si duhet planin kontabël.	I zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryesuesja e Bordit duhet të forcojë kontrollet në pranimin e mallrave dhe shërbimeve dhe procedimin e pagesave në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohen blerjet e pa kontrolluara.	KPMM ka ndërmarr veprime, që të gjitha faturat të pranohen pas zotimit dhe urdhërblerjes.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryesuesja e Bordit duhet të marrë veprimet e nevojshme për të siguruar se me rastin e formimit të komisioneve të merren parasysh parimet për ndarjen e detyrave, në rastet e mungesës së stafit brenda institucionit, të angazhojë ekspert nga jashtë në rastet kur kërkohet njohuri dhe ekspertizë e veçantë teknike.	KPMM ka ndërmarr masa që zyrtari që përgatit specifikimet teknike të mos jetë anëtarë i komisionit të vlerësimit.	I zbatuar

6.	Obligimet e papaguara	Kryesuesja e Bordit duhet të forcojnë masat e përgjegjësisë ndaj zyrtarëve financiar dhe zyrtarëve tjerë administrativ për të siguruar se të gjitha obligimet do të paguhen brenda 30 ditësh pas pranimit të faturave.	Edhe gjatë viti 2023, KPPM nuk kishte paguar me kohë obligimet.	Nuk ka filluar zbatimi
----	-----------------------	--	---	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Qëndresa Isufi, Udhëheqëse e ekipit



Besa Morina, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale  
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale  
Independent Commission for Mines and Minerals




### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,



Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Habib Basholli

  
Kryesues i Bordit të KPM-së  
Data: 07.06.2024, Prishtinë

Rr. Armend Daci Nr.1  
Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (38) 240 252  
Fax: +383 (38) 245 844  
E-mail: [ICMM@kosovo-mining.org](mailto:ICMM@kosovo-mining.org)  
Web: [www.kosovo-mining.org](http://www.kosovo-mining.org)

Kuvendi i Kosovës  
Skupština Kosova  
Assembly of Kosovo

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>7</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>8</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Çështja A1 - Mos përdorimi i modulit për menaxhimin e kontratave në sistem të prokurimit elektronik, janë, pesë raste:
- <sup>6</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>7</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>8</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.